REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE
DEGA TIRANE
NR 1169 REP/2
NR 458 KOL

Taksa e pulles likuiduar

VENDIM

LESHIM DESHMI TRASHIGIMIE LIGJORE

Në Tiranë,sot datë 25.05.2019, unë, Notere Drita Pepi, me adresë Rruga "Gjergj Fishta", pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqesor, mora ne shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e:

KERKUES *Naimir Kurti* ,atësia Luan, mëmësia Engjellushe,datelindjes 06.03. 1976, lindur ne Lushnje e me banim Tirane, Rruga "Reshit Çollaku", me shtetësi Shqiptare mbajtës i leternjoftimit H60306059V, *djali i trashigimlënësit.*

OBJEKTI I KERKESES Lëshim i dëshmisë së trashigimise ligjore përtrashigimlenesin, *Luan Kurti,* atesia Taip, mëmësia Zare, datëlindjes 10 .01. 1938, lindur Gurzer e me banim Tirane, Rruga" Durrësit" 60/3, njësia bashkiake nr 7,me shtetesi Shqiptare.

BAZA LIGJORE Neni 348 i Kodit Civil i ndryshuar, Ligji Nr. 121/2013,
Neni 111 - 113 i Ligjit nr. 110/2018 date 20.12.2018, "Për Noterinë".

Në përfudim të shqyrtimit te kërkesës dhe dokumentacionit, kërkuesi *Naimir Luan Kurti,* deklaroi se trashigimlënësi nuk ka lënë testament, nuk është bërë Çelje dëshmie trashigimie në vënd tjetër, prandaj kërkoi nga unë noterja pranimin e kërkesës per leshimin e deshmise ligjore per trashigimlenesin *Luan Taip Kurti.*

Pasi administrova dhe shqyrtova provat shkresore të administruara pranë kësaj Zyre Noterie si *Kërkesen, Çertifikatë vdekje të Luan Taip Kurti,leshuar nga Njesia Administrative 379 (014796726),Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashkiake nr 7 date 12.04.2019, Çertifikatën familjare,leshuar nga Qarku Tirane,Zyra e Gjendjes Civile Arkiva, Bashkia Tirane ne baze te regjistrit Lagjia 10 24/191 vitit 1950- 1974 me date 09.04.2019(015390054), leshuar nga Njesia Administrative Tirane 379,Zyra e Gjendjes Civile nr 7 (015433709) date 03.05.2019 ne baze te regjistrit themeltar te vitit 1974 Rruga e Durresit 1/87, Çertifikata Martese leshuar nga Qarku Tirane, Arkiva Bashkis Tirane (014787096) date 09.04.2019, ne baze te Librit te marteses lagje nr 8,Tirane Çertifikata personale e trashigimtareve, fotokopjen e kartës së identitetit të kërkuesit.*

KONSTATOVA

Se kërkuesi, *Naimir Kurti* ,atësia Luan, mëmësia Engjellushe,datelindjes 06.03. 1976, lindur ne Lushnje e me banim Tirane, Rruga "Reshit Çollaku", me shtetësi Shqiptare mbajtës i leternjoftimit H60306059V, *djali i trashigimlënësit,sikurse rezulton ne baze te Çertifikates Familjare, leshuar* me date 09.04.2019, nga Qarku Tiranë, Zyra e Gjendjes Civile Arkiva, Bashkia Tirane, ne baze te regjistrit themeltar te vitit 1950 - 1974, Lagjia Nr 10 24/191 dhe Çertifikates familjare te Regjistrit themeltar te vitit 1974, Rruga e Durresit 1/87 leshuar nga Njesia Aministrative Tirane 379, Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashiake nr 7,në bazë të Nenit 32 te Kodit te Proçedures Civile, legjitimohet për kërkesën qe i është drejtuar Zyrës së Noterisë *datë 12.04.2019,* për lëshimin e dëshmisë së trashigimisë ligjore për *Luan Taip Kurti.*

Në bazë të Nenit 46/1 të Kodit te Proçedures Civile, dhe Ligjit nr 110/ 2018 datë 20.12.2018, unë si notere me zyrë noteriale në Tiranë, Ruga"Gjergj Fishta", pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, kam kompetencën për shqyrtimin e kërkesës, pasi vendbanimi i fundit i trashigimlënësit rezulton të ketë qënë në Tirane,Rruga e Durrësit" 60/3.

Në bazë të Çertifikatës së Vdekjes, leshuar nga Njesia Administrative Tirane 379 Zyra e Gjëndjes Civile Njësia Bashkiake nr 7, date 12.04.2019), (014796726), vërtetohet se, *me date 04.03.2018, ka vdekur trashigimlenesi Luan Kurti,* atesia Taip, mëmësia Zare, datëlindjes 10 .01. 1938, lindur Gurzer e me banim Tirane, Rruga" Durrësit" 60/3, njësia bashkiake nr 7,me shtetesi Shqiptare.

Sipas deklarimit të vet kërkuesit dhe verifikimit që u bë pranë Dhomës Kombetare të Noterisë, *(kërkesa nr 121101, dt 12.04.2019),* rezulton se trashigimlënësi *Luan Taip Kurti,*nuk ka lënë testament e nuk është bëre çelje dëshmie në vënd tjetër.

Në kohën e vdekjes së trashigimlënësit *Luan Taip Kurti,* trashëgimia regullohet me Kodin Civil të miratuar me ligjin numër 7850 datë 29.07.1994, ndryshuar me Ligjin numër 8536 date 18.10.1999 dhe Ligjit numër 8781 datë 03.05.2001, sipas të cilit ne neni 318 parashikohet që *trashigimia çelet ne kohën kur vdes trashigimlenesi dhe në vendin ku ka patur banimin e fundit të tij. Në* referim të nenit 317 të këtij ligji *parashikohet se trashigimia me ligj zbatohet kur trashigimlënësi nuk ka bërë testament, ose ka bërë për një pjesë të pasurisë së tij,ose kur testament është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm.*

Në këto kushte çelet trashegimia ligjore për trashigimlënësin *Luan Taip Kurti* në bazë të nenit 361, ku sanksionohet se : *Në rradhë të pare thirren në trashigim fëmijët dhe bashkeshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar sejcili në pjesë të barabartë.*

Ne baze te Çertifikatës së trugut Familjar, leshuar me date 09.04.2019, nga Qarku Tiranë Zyra e Gjendjes Civile Arkiva, Bashkia Tirane, ne baze te regjistrit themeltar te vitit 1950 - 1974, Lagjia Nr 10 24/191 dhe Çertifikates familjare te Regjistrit themeltar te vitit 1974. Rruga e Durresit 1/87, leshuar nga Njesia Aministrative Tirane 379, Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashiake nr 7,te administruar ne dosje rezulton se trashegimtare ligjore e rradhes se pare jane *:*

Engjëllushe Mit hat Kurti, datelindjes 12.03.1940,(E05312107D),bashkeshortja
Taip Luan Kurti, datelindjes 12.09.1964, G40912111W, i biri.
Enkelev Luan Kurti, datelindjes 26.09.1966,G60926092G, i biri
Naimir Luan Kurti datelindjes 06.03. 1976,(H60306059V), i biri.

Nuk rezulton që trashigimlënësi të ketë të padenjë për të trashëguar, heqje dorë nga trashëgimia apo femijë jashtë martese.

Përsa me sipër unë Noterja çmoj se kërkesa e kërkuesit *Naimir Luan Kurti,* është e mbështetur në ligj ne neni 348 e vijues I Kodit Civil edhe në provat e administruara ne dosje.

Për këtë arsye
Unë Notere Drita.B.Pepi
në bazë të Nenit 348 të Kodit Civil i ndryshuar,
Ligji nr.110/2018 " Per Noterinë",

Vendosa

Pranimin e kërkesës.
Lëshimin e dëshmisë së trashigimisë ligjore për trashigimlënësin *Luan Taip Kurti,* duke përcaktuar si trashigimtarë ligjorë:

Engjëllushe Mit hat Kurti, bashkeshortja
Taip Luan Kurti, datelindjes 12.09.1964, i biri.
Enkelev Luan Kurti, datelindjes 26.09.1966, i biri
Naimir Luan Kurti datelindjes 06.03. 1976, i biri.

Te cilet trashigojne, sejcili nga 1/4/nje te katërtën/ e pjeses.

Në bazë të nenit 112, pika 2, të ligjit nr 110/2018, date 20.12.2008,"Për Noterinë" Zyra e Kadastrës, pamvarsisht rrethit të trashigimtarëve në çastin e rregjistrimit të pasurisë, nuk mund të cënojë pjesën e bashkëshortes të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës.

U shpall më datë 25.05.2019.

NOTERE
DRITA B. PEPI